

VENDIM
Nr. 733, datë 2.11.2012

**PËR PËRZGJEDHJEN, ME PROCEDURE TË PËRSHPEJTUAR, TË NJË STUDIOJE TË HUAJ
AVOKATIE PËR TË PËRFAQËSUAR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ME PADITËS
SHOQËRINË “SKY PETROLEUM INC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12 pikat 2 e 6, 15 pika 8 e 18 pika 2 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht procedurës dhe rregullave të përcaktuara në kreun III të rregullores së miratuar me vendimin nr. 392, datë 8.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale” dhe në kushtet e nevojës urgjente, të përzgjidhet, me procedurë të përshpejtuar, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, një studio e huaj avokatie për të përfaqësuar Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar me paditës “Sky Petroleum Inc”.

2. Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e studios së huaj të avokatisë janë:

a) specialiteti i avokatit/zyrës së avokatisë në fushën e objektit të çështjes për të cilën është vendosur fillimi i procedurës së kontraktimit;

b) numri i çështjeve të fituara në procedime të ngjashme;

c) besueshmëria dhe reputacioni.

3. Kriteret e veçanta dhe termat e referencës të përgatiten nga Avokatura e Shtetit dhe t’u njoftohen studiove të huaja të avokatisë, në ftesën për ofertë, gjatë fazës së propozimit dhe negocimit.

4. Avokatura e Shtetit, pas përgatitjes së termave të referencës, ua dërgon ftesën për ofertë, të paktën, dy studiove ligjore të huaja.

5. Përzgjedhja e studios së huaj të kryhet pas vlerësimit të, minimalisht, dy ofertave nga Avokatura e Shtetit dhe negocimit të çmimit të propozuar.

6. Pas marrjes së ofertës nga, të paktën, dy studio të huaja avokatie, Avokatura e Shtetit përzgjedh studion fituese në bazë të çmimit, reputacionit dhe cilësisë së shërbimit.

7. Avokatura e Shtetit autorizohet të lidhë kontratë me studion fituese, e cila duhet të miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

8. Pas miratimit të kontratës së lidhur nga Ministri i Drejtësisë, Avokati i Përgjithshëm cakton një avokat shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me subjektin e përzgjedhur.

9. Pas lidhjes së kontratës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton menjëherë Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili merr masa për të pajisur avokatin/zyrën e avokatisë së përzgjedhur me autorizimin përkatës për përfaqësim.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha